

Workshop Discussions | MINUTES

“Kontributi i DLDP për Strategjinë Decentralizimit” (diskutime me ekspertët)

Sesioni I: Financat lokale dhe buxheti (Standardet PFM): Parashikimi i të ardhurave dhe qëndrueshmëria e qeverisjen vendore në Shqipëri (analiza dhe rekomandime), si një kontribut për planin e veprimit / masave në identifikimin e masave të decentralizimit fiskal dhe buxhetimit .

Ekspertë: *Antonin Braho & Sabina Ymeri*

datë | 12/6/2014 9:30 AM | vendi DLDP, Zyra Tiranë

Organizuar nga:	DLDP	Moderator:	Erton Kashta
Formati i takimit:	Workshop	Përmbledhja:	Erida DOBRUSHI
Pjesëmarrës (vendos nr dhe listen e pjesemarrësve bashkangjitur):	me stafin e dldp, ekspertët e dldp Antonin Braho & Sabina Ymeri, SDC (Elda Bakaviki), PLGP (Fatlum Nurja, Silvana Meko), MoSLI (Edvin Puka), Bekim Murati (MoI), Jolanda Trebecka (eksperte e PLGP)		

gështjet e ngritura /propozime

Reforma administrativo-territoriale dhe Strategjia e Decentralizimit janë të lidhura me njëra-tjetrën, pavarësisht se reforma territoriale shkon drejt dekoncentrimit, ndërsa strategjia promovon decentralizimin.

Në rast se do ti referohemi edhe eksperiencave të vendeve të zhvilluara të rajonit, decentralizimi kërkon dekada që të jap efektet e tij, prandaj është e domosdoshme që implementimi i kësaj strategjie të jetë fleksibël.

Ekspertët diskutuan dhe ranë dakort se është shumë e rendësishme, që për vet kompleksitetin dhe gjithëpërfshirjen që kërkon zbatimi i kësaj strategjie, duhet që Entiteti i cili do të ketë detyrimin monitorimit të implementimit të saj, të ketë pushtetin e duhur dhe të ofrojë ekuilibrin dhe stabilitetin politik, në mënyrë që të kemi fleksibilitet dhe qëndrueshmëri në zbatimin e kësaj strategjie.

Njqv-të nuk kanë akses në kohë reale për shumë të dhëna që administrohen nga pushteti qendror/agjensitë e dekoncentruara, por që janë të nevojshme për tu përdorur nga NJQV-të pasi lidhen me popullsinë, administrimin e pronës dhe bizneseve të cilat janë objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Pavarësisht efekteve të reformës territoriale, zyrat të cilat aktualisht ofrojnë shërbime në NJQ-të

ekszistuese do të vazhdojnë ti ofrojnë këto shërbime. Mbetet për tu diskutuar dhe vlerësuar mundësia që këtyre Zyrrave tu alokohen funksione të tjera, përveç atyre ekzistuese.

Duhet gjetur mekanizma ligjore për stimulimin financiar për tërheqjen e burimeve njerëzore dhe ngritjen e kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve. Përdorimi i një mekanizmi të tillë, do të frenonte orientimin e popullsisë drejt qendrave të mëdha urbane.

Duhet të ruhet Qarku si strukturë administrative (pavarësisht nga emërtimi që mund të marrë), pasi është një element që luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social.

Në bazë të statistikave, qeveria vendore është e fundit në nivelin financiar në raport me GDP-në, ndërkohë që vet NJQV-të nuk arrijnë të realizojnë dot të ardhurat e tyre. Këto 2 faktorë cojnë në domosdoshmërinë e angazhimit që duhet të merret për rritjen e % (përqindjes) së financimit në raport me GDP-në, si dhe rritjen e kompetencave të qeverisjes vendore për të mundësuar realizimin e të ardhurave.

Në funksion të diskutimeve dhe arsyetimeve të mësipërme, del si domosdoshmëri që Strategjia e Decentralizimit të jetë një dokument i miratuar me ligj dhe jo me akt i miratuar vetëm me Vendim të Këshillit të Ministrave, në mënyrë që të ofrojë më tepër qendrueshmëri, fleksibilitet, të jetë i efektivisht i monitorueshëm, të garantojë gjithëpërfshirje dhe ti jap pushtetin e duhur Entitetit zbatues e monitorues.

Është i domosdoshëm krijimi i Fondit për mbështetjen e procesit të decentralizimit (paketë financiare), i cili duhet të mbështesë disakordancat që do sjellë zbatimi i reformës administrativo-territoriale dhe zbatimi i Strategjisë së Decentralizimit.

Strategjia duhet të marrë në konsideratë mekanizma fleksibël për kalimin e funksioneve të përbashkëta bazuar në kapacitetet reale të NJQV-ve.

Duhet miratuar ligji për Menaxhimin e Financave Vendore. Me miratimin e reformës administrativo-territoriale ky ligj duhet të përcaktojë ndër të tjera rregullat për vlerësimin e aseteve, bashkimin financiar dhe unifikimin e bilancit.

Në kushtet e miratimit dhe zbatimit të reformës administrativo-territoriale, është e rëndësishme që të përfshihet në strukturën e ndërtimit të Strategjisë së Decentralizimit një kapitull "Tranzicioni për implementimin e Strategjisë".

Closing: 10: 30 PM

List of participants

Tirana on, 13 June 2014

No.	Organization	Name	Position	Email	Tel
1	PLGP/USAID	Fatlum Nurja	Expert	fnurja@plgp.al	692075434
2	MoSLI/PLGP	Edvin Puka	Coordinator	edvinpuka@gmail.com	684072078
3	DLDP	Erton Kashta	DPM Tirane	erton.kashta@helvetas.org	692041002
4	DLDP	Erida Dobrushki	SPO Tirane	erida.dobrushki@helvetas.org	692047005
5	EPO	Jolanda Trebicka	Expert	jolanda.trebick@europartyners.al	692052966
6	SDC/free lence	Aida Gugu	Consultant	aidagugu@gmail.com	676060501
7	DoPA	Erton Karagjozi	Chief of Sector	ertonkaragjozi@gmail.com	673796150
8	MiE	Anila Dollani	Expert	aida.dollani@integrimi.gov.al	666032280
9	Mol	Bekim Murati	Director/Coord.	bekim.murati@moi.gov.al	692082774
10	SDC	Elda Bakaviki	NPO	elda.bakaviki@eda.admin.ch	682060482
11	Expert	Sabina ymeri	Expert	sabina.ymeri@gmail.com	692054167
12	Expert	Antonin Braho	Expert	antonin.braho@gmail.com	684099222



Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Conderazione Svizzera
Confederaziun svicra

Swiss Agency for Development
And Cooperation SDC



HELVETAS
Swiss Intercooperation

ALBANIA